**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Jugore**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**Kryetari i Komunës**
**Nr.** 01-020/04-0024828-2/26 dt. 12.06.2026
**Mitrovicë e Jugut**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Propozim-Vendimin Nr. 01-020/04-0024828/26, dt. 04.05.2026, të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryetari i Komunës sjell këtë:

**V E N D I M**
**(Për Formimin e Komisionit për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale Nr. 02/2019 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 01/2024)**

1. **FORMOHET** Komisioni për Hartimin e Ndryshim-Plotësimit të Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale Nr. 02/2019 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 01/2024, në këtë përbërje:

   **1.1** Ermir Beqiri – kryetar (DBF);
   **1.2** Fatime Hyseni – anëtare (DSHPI);
   **1.3** Sebahate Tahiri – anëtare (DPU).

2. Komisioni është përgjegjës që të bëj ndryshimin e Rregullores Komunale Nr. 02/2019 për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 01/2024, duke bërë harmonizimin e këtyre ndryshimeve, dhe duke përfshirë kërkesat dhe nevojat e drejtorive komunale në bazë të dispozitave ligjore pozitive në fuqi.

3 Komisioni obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores për Ndryshimin e Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.

4 Komisioni bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit e Akteve të Komunës, Rregulloren Komunale Nr. 02/2019 për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale e plotësuar dhe

ndryshuar me Rregulloren Nr. 01/2024, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5 Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.

6 Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PECI

**Shtojcë:**

Propozim-Vendimi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Nr. [illegible]/04-0024828/226, dt. 04.05.2026.

**T'i dërgohet:**

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit